Raporti për të Drejtat e Njeriut për Vitin 2013

SHQIPËRIA
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Republika e Shqipërisë është demokraci parlamentare. Kushtetuta ia njeh autoritetin ligjor parlamentit me një dhomë (Kuvendit), i cili zgjedh si kryeministrin ashtu edhe presidentin. Kryeministri kryeson qeverinë, ndërsa presidenti zotëron pushtet të kufizuar ekzekutiv. Më 23 qershor vendi zhvilloi zgjedhjet parlamentare, të cilat Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) e Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (OSBE) i përcaktoi si konkurruese dhe në përputhje me të drejtat themelore, por të zhvilluara në një atmosferë mosbesimi e cila ndikoi mjedisin zgjedhor. Forcat e sigurisë u raportuan autoriteteve civile. Forcat e sigurisë shkaktuan abuzime me të drejtat e njeriut.

Problemet më thelbësore në lidhje me të drejtat e njeriut ishin: korrupsioni i përhapur në të gjitha degët e qeverisjes, veçanërisht brenda sistemit gjyqësor; bllokimi i axhendës së reformave, në veçanti lufta kundër korrupsionit, për shkak se partitë politike u përqendruan te zgjedhjet e qershorit; dhe dhuna në familje e diskriminimi i grave.

Problemet e tjera në lidhje me të drejtat e njeriut përfshinin rrahje nga policia dhe keqtrajtime të formave të tjera të të dyshuarve gjatë ndalimit dhe marrjes në pyetje, disa herë për t'u marrë rrëfime; kushtet e burgjeve nën standarde, sistem gjyqësor joefikas nën presionin politik dhe korrupsionin e përhapur si edhe abuzimi i fëmijëve. Vazhduan të përbënin problem fëmijët e rrugës dhe ata të zhvendosur, veçanërisht në radhët e komunitetit rom. Lënia mënjanë dhe abuzimi me komunitetet rome dhe ato egjiptiano-ballkanike ishin probleme serioze. Diskriminimi mbi bazën e orientimit seksual dhe identitetit gjinor kanë qenë gjithashtu problematikë. Vazhduan të raportoheshin raste të trafikimit të personave.

Pandëshkueshmëria vazhdoi të mbetej problem. Përpjekjet e qeverisë për të ndjekur penalisht zyrtarë që kishin kryer abuzime ishin të sporadike dhe të paqëndrueshme. Zyrtarët e qeverisë dhe politikanët si edhe gjyqtarë e persona me interesa të fuqishme biznesi shpesh ia dilnin të shmangnin ndjekjen penale. Janë dënuar për abuzime zyrtarë të niveleve të ulëta. Disa zyrtarë të qeverisë që kanë qenë dukshëm të përfshirë në raste abuzive janë shkarkuar dhe transferuar në poste të tjera qeveritare pa marrë asnjë ndëshkim.

Seksioni 1. Respektimi i integritetit të personit, përfshirë lirinë nga:
a. Privimi i jetës në mënyrë arbitrare apo të paligjshme

Në shtator, gjykata e apelit që mori nën shqyrtim vrasjen në vitin 2011 të katër protestuesve përpara ndërtesës së kryeministrisë mbështeti shfajësimin e punonjësit të gardës së republikës Margarit Kume për pengim të drejtësisë, por shpalli anëtarët e Gardës së Republikës Ndrea Prendi dhe Agim Llupo fajtorë për akuza më të lehta për vrasje nga pakujdesia dhe i dënoi ata përkatësisht me një dhe tre vjet heqje lirie. Koha e paraburgimit u llogarit si pjesë e dënimit. Në tetor prokurorët bënë rekurs për këtë çështje në Gjykatën e Lartë, ku kërkuan dënim me 23 dhe 25 vjet përkatësisht për Prendin dhe Llupon.

Gjatë vitit qeveria bashkëpunoi me hetimin e Task-Forcës Speciale Hetimore të Bashkimit Europian në lidhje me pretendimet ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe degëve të saj se kanë

ndaluar shtetas të etiketuar si "të burgosur lufte" civilë nga Kosova në disa vende në Shqipëri, i kanë mbajtur në kushte çnjerëzore, i kanë vrarë rreth periudhës nga viti 1999 deri në mesin e vitit 2000 dhe më pas kanë trafikuar organet e tyre.

Kanë ndodhur gjatë vitit raste vrasjesh shoqërore, përfshirë vrasje për gjakmarrje dhe vrasje prej hakmarrje. Në disa raste kanë, në këto vrasje kanë qenë të përfshira banda kriminale. Edhe pse traditat e vjetra në lidhje me gjakmarrjen ndalojnë vrasjen e fëmijëve dhe grave, organizatat joqeveritare (OJQ) raportuan raste në të cilat vrasësit qëllimisht kanë vënë në shënjestër të mitur dhe gra. Avokati i Popullit raportoi raste në të cilat autoritetet nuk kanë pranuar të mbrojnë familje apo të ndalojnë vrasjet për gjakmarrje.

Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri raportoi tre vrasje për gjakmarrje gjatë vitit. OJQ të tjera kanë raportuar numër më të lartë vrasjesh për gjakmarrje, por nuk ka të dhëna të besueshme. Rastet e gjakmarrjes gjykohen nga gjykatat e rretheve. Ligji dënon vrasjen me paramendim, kur kjo kryhet për hakmarrje apo gjakmarrje, deri në 20 vjet heqje lirie.

b. Zhdukja
Nuk pati raportime për zhdukje personash për motive politike.

c. Tortura dhe trajtime apo ndëshkime të tjera mizore, çnjerëzore ose denigruese
Ndonëse kushtetuta dhe ligji i ndalojnë vepra të tilla, policia dhe rojet e burgjeve hera-herës rrahënn dhe abuzuan me të dyshuarit apo të ndaluarit.

Avokati i Popullit mandatohet nga ligji që nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës të monitorojë dhe raportojë në lidhje me burgjet dhe qendrat e paraburgimit. Gjatë vitit, Avokati i Popullit dhe OJQ-të raportuan se kushtet në pjesën më të madhe të burgjeve dhe qendrave të paraburgimit u përmirësuan, megjithëse në disa mjedise vazhduan të ekzistonin probleme serioze. Në vitin 2012, Avokati i Popullit mori nga të burgosurit dhe të ndaluarit 386 ankesa për abuzime fizike dhe torturë, ndalim të paligjshëm, kërkime dhe kapje të paligjshme, gjoba të paligjshme, dhunim të privatësisë, poshtërim dhe mosdhënie të duhur të informacionit. Avokati i Popullit raportoi gjithashtu mungesë të kujdesit të duhur mjekësor në shumë burgje e qendra paraburgimi si edhe kushte jetese të papërshtatshme.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) raportoi se policia në disa raste tejkalonte përdorimin e forcës apo se kushtet në disa ndërtesa ku policia mbante të ndaluarit ishin aq të papërshtatshme sa përbënin trajtim çnjerëzor. Pjesa më e madhe e ankesave përfshinte shoqërime të pajustifikuara nga policia, mbajtje nën arrest përtej afateve ligjore, mosnjohje e shtetasve me të drejtat e tyre kur ndaloheshin dhe kushte të papranueshme në qendrat e paraburgimit. KSHH deklaroi se policia shpesh raportonte se të ndaluarit me pretendime abuzimi kishin ardhur me lëndime/plagë të mëparshme.

OJQ-të raportuan se ankesat nga të ndaluarit e mitur për abuzim fizik apo dhunë brenda qendrave të paraburgimit dhe burgjeve rrallë ishin marrë seriozisht.

Gjatë vitit, Avokati i Popullit raportoi se prokuroria si fillim pranoi kërkesën e tij të vitit 2012 për të hapur hetim penal për akuzat se pesë roje kanë torturuar dy të burgosur në burgun Jordan Misja në Tiranë, por më pas e pushoi çështjen.

Kushtet në burgje dhe në qendrat e paraburgimit

Kushtet në burgje dhe në qendrat e paraburgimit ndryshonin shumë nga një ndërtesë në tjetrën. Vendi vazhdoi procesin e zëvendësimit të disa mjediseve të vjetra ku kushtet ishin të vështira e kërcënuese për jetën, ndërsa ndërtesat e reja të ndërtuara pas vitit 1991 në përgjithësi ishin në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kushtet e mjediseve nën kontrollin e Ministrisë së Drejtësisë në përgjithësi ishin qenë më të mira se ato të mjediseve nën kontrollin e Ministrisë së Brendshme.

Kushtet fizike: Deri në tetor, kishte 2.090 persona në qendrat e paraburgimit në pritje të gjykimit dhe 3.111 persona të dënuar në burgje, ku përfshiheshin 87 të burgosura femra dhe 104 të mitur. Autoritetet i mbanin burrat dhe gratë në mjedise të ndara, si edhe të ndaluarit në pritje të gjykimit të ndarë nga të dënuarit me burgim. Kushtet e burgut të grave dhe qendrave të ndalimit të grave në përgjithësi ishin më të mira se ato të mjediseve të burrave.
Deri në tetor kishte nëntë vdekje të regjistruara në burgje: shtatë për shkaqe natyrale, një etëvrasje dhe një vdekje që ishte ende në hetim nga autoritetet, sipas Avokatit të Popullit. Gjatë vitit, prokuroria nuk pranoi të hetonte çështjen e vitit 2012 të vdekjes së një të burgosuri për të cilin pretendohej se nuk i ishte dhënë kujdes mjekësor dhe ishte mbajtur i kufizuar në shtrat. Ai u gjend i mbuluar në urinë dhe fekale pasi kishte vdekur në qelinë e tij.

Mjediset e vjetra kishin furnizim të pamjaftueshëm me ujë të pijshëm, pastrim, ajrim, ndriçim dhe kujdes shëndetësor. Ndërtesat e vjetra kishin kushte johigjienike dhe mungesa të shumta të kushteve bazë. Gjithashtu, keqtrajtimi nga ana e rojeve dhe të burgosurve mes tyre kërcënonin jetën dhe shëndetin e të dënuarve dhe të ndaluarve. Avokati i Popullit dhe KSHH raportuan se të ndaluarit dhe dënuarit nuk kishin mundësi të mjaftueshme për kontrolle mjekësore dhe shërbime të tjera.

Rajonet e policisë dhe mjediset e paraburgimit të përkohshëm ishin nën kontrollin e Ministrisë së Brendshme. Kushtet në këto mjedise ishin tërësisht të papërshtatshme. Në disa raste, nuk kishte ngrohje gjatë dimrit. Disa kishin mungesa të kushteve bazë të higjienës si dushe dhe lavamanë, banja të pamjaftueshme dhe pak ose aspak ajrim apo shfrytëzim të dritës natyrale, nuk kishin shtretër apo stola dhe ishin mjedise shumë të vogla.

Administrimi: OJQ-të vunë re se në shumë institucione nuk kishte regjistrim të mirë të informacionit. Të dënuarit dhe të ndaluarit kanë të drejtën të takojnë të afërmit, me takime deri në katër herë në muaj për të rriturit dhe deri në tetë herë për të miturit. Të dënuarit dhe të ndaluarit kishin liri ushtrimi të besimit fetar dhe disa mjedise kishin vende te posaçme për shërbime fetare. Të dënuarit dhe të ndaluarit u lejuan të paraqitnin ankesa pranë Avokatit të Popullit dhe autoriteteve gjyqësore dhe administrative. Çdo mjedis vuajtjeje dënimi kishte kuti postare ku të dënuarit dhe të ndaluarit kishin të drejtë të hidhnin ankesa pa u censuruar. Të dënuarit kishin të drejtën e takimit konfidencial me Avokatin e Popullit, Komisionin Mbikëqyrës

të Burgjeve, apo me OJQ të huaja ose vendase për të drejtat e njeriut. Avokati i Popullit raportoi se zyrtarët e burgjeve në përgjithësi kanë bashkëpunuar me hetimet e këtij institucioni; megjithatë, burgjet nuk zbatuan tërësisht rekomandimet e Avokatit të popullit. OJQ-të raportuan se qeveria i mori më seriozisht sugjerimet e tyre por vazhduan të mos pranonin hetimin e disa çështjeve. Vendi përdori alternativa për dënime me burgim.
Autoritetet hetuan disa pretendime të besueshme për kushte çnjerëzore dhe dokumentuan rezultatet e hetimeve të tyre. Avokati i Popullit zbuloi se korrupsioni është problem serioz në qendrat e paraburgimit, veçanërisht me programe të pajisjes me leje dalje të veçantë. Pati disa raporte se të burgosurit kanë përfituar nga programe të pajisjes me leje dalje të veçantë pasi u kanë dhënë ryshfet zyrtarëve.

Monitorimi i pavarur: Qeveria lejoi monitorimin e kushteve të burgjeve nga grupe vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, nga media dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq si edhe nga organizma ndërkombëtare si Komiteti për Parandalimin e Torturës.

Përmirësime: Avokati i Popullit dhe OJQ-të raportuan se kushtet në pjesën më të madhe të burgjeve dhe qendrave të paraburgimit u përmirësuan gjatë vitit. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës shtoi numrin e inspektimeve me 41 për qind dhe mori 48 për qind më pak ankesa kundër policisë dhe burgjeve. Gjatë vitit qeveria përfundoi ndërtimin në tre mjedise të reja paraburgimi dhe nisi ndërtimin në dy të tjera. Dy mjedise të vjetra u mbyllën në fund të vitit. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve urdhëroi sistemin e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit të përmirësonin regjistrimin e informacionit, sipas rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Regjistrimi i informacionit u përmirësua nëpërmjet një sistemi elektronik.

d. Arrestimi dhe ndalimi në mënyrë arbitrare

Ligji dhe kushtetuta ndalojnë arrestimin dhe ndalimin në mënyrë arbitrare; megjithatë, pati raporte se policia në disa raste arrestoi dhe ndaloi persona në mënyrë arbitrare.

Roli i Policisë dhe Aparatit të Sigurisë

Policia është nën kontrollin e Ministrisë së Brendshme. Policia e Shtetit është organizata kryesore përgjegjëse për sigurinë e brendshme. Garda e Republikës mbron zyrtarët shtetërorë të niveleve të larta, personalitetet e huaja dhe disa prona shtetërore. Ministria e Mbrojtjes kontrollon forcat e armatosura të vendit, të cilat gjithashtu ndihmojnë popullsinë në kohë krizash humanitare. Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) mbledh informacion dhe kryen veprimtarinë e zbulimit të huaj dhe kundërzbulimit.

Autoritetet civile në përgjithësi ushtruan kontroll efikas mbi Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, forcat e armatosura dhe SHISH-in, edhe pse në disa periudha burimet shtetërore u përdorën për përfitime personale dhe disa anëtarë të forcave të sigurisë kryen abuzime.

Oficerët e policisë së shtetit nuk kanë zbatuar gjithmonë ligjin në mënyrë të barabartë. Lidhjet personale, lidhjet politike apo kriminale, infrastruktura e dobët dhe mungesa e pajisjeve apo kontrolli i pamjaftueshëm shpesh ndikuan në zbatimin e ligjit. Pagat e ulëta, motivimi dhe drejtimi i dobët, si edhe mungesa e shumëllojshmërisë në personel çuan në raste të përsëritura

korrupsioni dhe sjellje joprofesionale. Pandëshkueshmëria mbeti problem serioz dhe pak oficerë policie u ndoqën penalisht për abuzime.

Qeveria ka mekanizma për të hetuar dhe ndëshkuar abuzimin dhe korrupsionin. Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm kreu kontrolle, iu përgjigj ankesave dhe bëri hetime me më shumë forcë për të drejtat e njeriut, kushtet e burgjeve dhe veprimet në përputhshmëri me procedurat standarde të punës; megjithatë, pati raportime të shumta se policia me raste pranonte ryshfet në këmbim të mosreferimit apo mos-hedhjes së informacioneve personale në bazën e të dhënave kriminale.

Gjatë vitit Avokati i Popullit përpunoi ankesa kundër oficerëve të policisë kryesisht në lidhje me probleme arrestimi dhe ndalimi. Avokati i Popullit mori 139 ankesa deri në tetor dhe hetoi ose dha këshillime për 107 raste.

Komisioni Europian raportoi se gjatë vitit policia firmosi një marrëveshje bashkëpunimi me një OJQ të tretë për të monitoruar mjediset e ndalimit, përfshirë vizitat e panjoftuara. Komisioni raportoi se të gjithë punonjësit e policisë ishin të trajnuar për të drejtat e njeriut, dhe Protokolli i Stambollit për dokumentimin e keqtrajtimit u përhap nga burgjet deri te komisariatet rajonale të policisë. Drejtoria e Burgjeve miratoi udhëzime për menaxhimin e grevës së urisë. Avokati i Popullit, nëpërmjet MKPT-së, raportoi bashkëpunim më të gjerë nga ana e forcave të sigurisë me hetimet dhe rritje të zbatimit të rekomandimeve të tij mbi keqtrajtimin.

Procedurat e arrestimit dhe trajtimi gjatë paraburgimit
Kushtetuta kërkon lëshim nga ana e gjykatësit të një fletë-arresti për ndalim bazuar në prova të mjaftueshme. Nuk pati raporte për arrestime sekrete. Sipas ligjit policia duhet të njoftojë menjëherë prokurorinë për arrestimin. Prokuroria mund ta lirojë të ndaluarin apo t'i bëjë kërkesë gjykatës brenda 48 orësh për ta mbajtur të ndaluar për më gjatë. Gjykata duhet të vendosë brenda 48 orësh nëse do e vendosë të dyshuarin në paraburgim, do të kërkojë garanci, ndalojë lëvizjet, apo të kërkojë të pandehurin të paraqitet rregullisht në polici. Prokuroria kërkoi dhe gjykatat rregullisht urdhëruan ndalim në shumë raste penale. Megjithatë, gjykatat rregullisht refuzuan kërkesat e prokurorëve për ndalim të të pandehurve me lidhje të forta e me pozitë.

Kushtetuta u kërkon autoriteteve të njohin personat e ndaluar menjëherë me akuzën e ngritur kundër tyre dhe me të drejtat që zotërojnë; megjithatë, kjo e drejtë nuk u respektua gjithmonë. Nuk ka sistem efikas për menaxhimin e aspektit financiar të garancisë. Në vend të kësaj, shpesh gjykata kërkon që të dyshuarit të paraqiten në polici apo prokurori çdo javë. Autoritetet u dhanë mundësi të menjëhershme të ndaluarve për të marrë avokat, kur nevojiten, me shpenzimet e shtetit. Shumë të dyshuar u urdhëruan të qëndronin në arrest shtëpie, shpesh me kërkesën e tyre, sepse u llogaritej koha në arrest si kohë shërbimi nëse dënoheshin më pas. Arresti në shtëpi nuk u monitorua në mënyrë efikase, dhe të dyshuarit mund të dilnin lirisht pa u kapur nga autoritetet.

Sipas ligjit personat e ndaluar duhet të kalojnë nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka mjedise më të përshtatshme për të ndaluarit me afat të gjatë, nëse arresti i kalon 10 orë. Për shkak të komunikimit jo të mirë mes ministrive, kjo ndodhi rrallë dhe rëndom personat, përfshirë edhe të mitur, mbeteshin në qendrat e paraburgimit të policisë për periudha të gjata.

Arrestimi në mënyrë arbitrare: Policia me raste ndaloi persona për periudha kohore shumë të gjata për t'i marrë në pyetje, pa i arrestuar ata formalisht.
Ndalimi në pritje të gjykimit: Ndonëse ligji kërkon përfundim të pjesës më të madhe të hetimeve përpara gjykimit brenda tre muajsh, prokurori mund ta shtyjë këtë periudhë deri në dy vjet ose më shumë. Ligji parashikon që periudha maksimale e ndalimit përpara gjykimit të mos i kalojë tre vjet; nuk ka patur raportime të thyerjes së këtij kufiri gjatë vitit. Ndalimet e zgjatura përpara gjykimit shpesh ndodhën për shkak të hetimeve të vonuara, gabimeve në mbrojtje, apo mosparaqitjes së qëllimshme të avokatit mbrojtës. Sipas ligjit, gjykatësi nuk mund ta akuzojë avokatin për shpërfillje të gjykatës nëse nuk paraqitet, në mënyrë që të shmangeshin veprime të tilla që sjellin vonesa nga ana e avokatëve. Burimet e kufizuara materiale, mungesa e hapësirës, menaxhimi jo i mirë i kalendarit të veprimeve nga ana e gjykatave, personeli i pamjaftueshëm, dhe mosparaqitja e avokatëve dhe dëshmitarëve penguan sistemin gjyqësor të merrte vendime për çështjet duke respektuar afatet kohore. Deri në tetor, 40 për qind e totalit të popullsisë së burgjeve/qendrave të paraburgimit ishte në ndalim në pritje të gjykimit.

e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Kushtetuta parashikon pushtet gjyqësor të pavarur; megjithatë, trysnia politike, kërcënimi, korrupsioni i përhapur dhe burimet e kufizuara penguan me raste gjyqësorin të funksionojë në mënyrë të pavarur dhe efikase. Gjithashtu, seancat dëgjimore në gjykata shpesh bëheshin të mbyllura për publikun. Punonjësit e sigurisë së gjykatave rregullisht nuk lejuan hyrjen në seanca dëgjimore dhe po rregullisht merrnin në telefon gjykatësin drejtues të çështjes për të pyetur nëse personi që kërkonte të hynte mund të lejohej apo jo. Disa agjenci shpesh shpërfillën urdhrat e gjykatës. Politizimi i emërimeve në Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese kërcënoi të minonte pavarësinë dhe integritetin e këtyre institucioneve.

Procedurat e gjykimit

Ligji parashikon se i pandehuri konsiderohet i pafajshëm derisa t'i jepet dënimi. Ligji u jep të drejtën të pandehurve të informohen menjëherë dhe me detaje në lidhje me akuzat, me përkthim falas nëse është e nevojshme, si edhe të drejtën për gjykim publik të lirë e të drejtë pa vonesa. Sistemi gjyqësor nuk garanton gjykime me juri. Të pandehurit kanë të drejtë të konsultohen me avokat, dhe t'u sigurohet një i tillë me shpenzimet e shtetit nëse nuk e përballojnë dot. Ligji u garanton të pandehurve kohë të mjaftueshme dhe mjedise për të përgatitur mbrojtjen, si edhe të shqyrtojnë provat e prokurorisë. Të pandehurit kanë të drejtën të përballen me dëshmitarët kundër tyre dhe të paraqesin dëshmitarë dhe prova në mbrojtjen e tyre. Të pandehurit nuk mund të detyrohen të dëshmojnë apo rrëfejnë fajësi. Të pandehurit kanë të drejtë të apelojnë. Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta.

Të dënuarit dhe të ndaluarit politikë

Nuk pati raportime për të burgosur apo të ndaluar për motive politike. Ish të dënuarit politikë nën regjimin komunist vazhduan t'i kërkonin kompensim qeverisë. Në disa raste gjatë vitit, grupe ish të dënuarish politikë u përpoqën të protestonin kundër mospagimit nga qeveria të kompensimit dhënë atyre në mënyrë të ligjshme. Në thuajse çdo rast, autoritetet ndaluan organizimin e protestës dhe arrestuan organizatorët.

Procedurat gjyqësore dhe kompensimet civile

Ndërsa individët dhe organizatat mund të kërkojnë kompensime civile për dhunim të të drejtave të njeriut, gjykatat ishin pre e korrupsionit, inefikasitetit, kërcënimeve dhe ngacmimeve politike.

U mbajtën shumë seanca dëgjimore në zyrat e gjyqtarëve, të cilat çuan në mungesën e profesionalizmit dhe mundësi për korrupsion. Këto faktorë ulën autoritetin e gjyqësorit, çuan në vendime të diskutueshme gjykatash dhe në zbatime kontradiktore të ligjit.

Vendime të gjykatës rajonale të të drejtave të njeriut
Shtetasit mund të apelonin vendimet që përfshinin pretendime për dhunim të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut nga shteti në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata nxori 30 gjykime kundër vendit, nga të cilat tre nuk u ekzekutuan plotësisht.

Kthimi i pronës
Një numër i madh pretendimesh kundërshtuese për prona private dhe fetare të konfiskuara gjatë regjimit komunist mbetën të pazgjidhura. Ekspertët e Bankës Botërore deklaruan se duke patur parasysh ritmin e ngadaltë të kthimit, qeverisë do t'i duhen 38,6 miliard dollarë dhe 30 vjet për të përfunduar këtë proces. Qeveria nuk ndoqi ndonjë sistem efikas për kthimin e pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist.

Në 23 prill, një zyrë private përmbarimi nxori duke kërcënuar me arme 14 familje nga një pallat në Tiranë, me pretendimin se po zbatonte një urdhër gjykate për kthimin e pronës pronarit të kohës së komunizmit. Familjet bënë grevë urie për t'i kërkuar qeverisë t'u ofronte rekurs. Prokuroria e Tiranës nisi procedura penale ndaj agjencive vendore që kishin lëshuar urdhrin në fillim dhe familjet e nxjerra nisën procedura civile kundër zyrës private të përmbarimit. Këto çështje ishin ne vazhdim deri në tetor.

f. Ndërhyrje arbitrare në privatësi, familje, shtëpi dhe korrespondencë
Pati incidente ku qeveria konfiskoi apo u përpoq të konfiskonte prona pa bërë procedurat e duhura gjatë vitit. Në nëntor Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar (INUK) mbështetur nga policia e shtetit u përpoq të nxirrte pronarët nga shtëpitë e tyre në një pallat në Vlorë. Këto familje kishin pronësinë e banesave nga zyra përkatëse e regjistrimit të pronës. Ato raportuan se ishin ndaluar nga policia të hynin në shtëpitë e tyre duke iu thënë se qeveria po e sekuestronte ndërtesën për shkatërrim. Avokati i Popullit raportoi se veprimet e qeverisë kishin shkelur procedurat. Zyrtarë të qeverisë deklaruan se ndërtesa ishte ndërtuar në mënyrë të paligjshme dhe shkelte kushtet e lejes. Gjykata Administrative Rajonale e Vlorës vendosi në favor të banorëve të ndërtesës dhe urdhëroi qeverinë të pezullonte veprimet e saj.

Seksioni 2. Respektimi i të drejtave të njeriut, përfshirë:
a. Liria e fjalës dhe e shtypit
Kushtetuta siguron lirinë e fjalës dhe të shtypit, dhe qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta. Pati raportime se qeveria dhe bizneset ndikuan dhe ushtruan presion mbi median.

Liria e Fjalës: Individët në përgjithësi patën mundësinë të kritikonin qeverinë në mënyrë publike apo private pa pësuar masa ndëshkimore; megjithatë, pati raportime se qeveria u kërkoi punonjësve të merrnin pjesë në protesta gjatë fushatës.

Anëtarë të një grupi ish të dënuarish politikë nga regjimi komunist të cilët i bënë kërkesë qeverisë për kompensim raportuan se zyrtarë të sigurisë së shtetit rregullisht monitoruan lëvizjet e tyre dhe i provokuan ata dhe anëtarë të familjeve të tyre.

Liria e shtypit: Mediat e pavarura ishin aktive dhe gjerësisht të pakufizuara, megjithëse pati raste presioni të drejtpërdrejtë ose të tërthortë politik dhe ekonomik mbi median, përfshirë kërcënime kundër gazetarëve. Pati raste kur presioni politik dhe mungesa e fondeve kufizuan median e shkruar të pavarur dhe gazetarët raportuan se kishin praktikuar vetë-censurim. Partitë politike, sindikatat dhe grupe të tjera botuan gazeta dhe revista të pavarura nga ndikimi i qeverisë.
Në raportin vjetor Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias, organizata joqeveritare IREX vërejti se pavarësia e medias në vend as nuk u përmirësua as u përkeqësua në krahasim me vitin e mëparshëm.

Qeveria kontrolloi linjën editoriale të Radios dhe Televizionit Publik Shqiptar, të cilët kanë në administrim një kanal televiziv kombëtar dhe një stacion kombëtar radioje dhe me ligj, morën 50 për qind të buxhetit nga qeveria. Ndonëse stacionet private në përgjithësi funksionuan të pavarura nga ndikimi i drejtpërdrejtë i qeverisë, shumica e pronarëve besonin se përmbajtja e transmetimeve të tyre mund të ndikonte veprimet e qeverisë drejt bizneseve të tjera të tyre. Pronarët e bizneseve gjithashtu përdorën lirisht grupet mediatike për të përfituar favore dhe për të nxitur interesat e tyre me të dyja partitë e mëdha politike. Shumë pronarë mediash kandisnin drejtues të qeverisë për të përfituar favore prej tyre apo për të shmangur taksat.

Media raportoi se qeveria shpërndau fondet publike për reklama në grupe mediatike bazuar në përfitime dhe lidhje personale e politike e jo në bazë të shikueshmërisë apo numrit të lexuesve.

Dhuna dhe ngacmimi: Pati incidente dhune kundër anëtarëve të medias transmetuese gjatë vitit, dhe aktorët politikë e të biznesit u bënë presion gazetarëve.
Në 7 prill policia shoqëroi Gent Balltën, kameraman i televizionit kombëtar jopublik Top Channel, pas një ndeshjeje futbolli që çoi në përplasje mes tifozëve të klubit të futbollit dhe punonjësve të policisë. Ballta tha se po filmonte përplasjen dhe se policia e ndaloi atë mes tifozëve. Gjatë shoqërimit në rajonin e policisë Tiranë, ai pretendoi se policia e kishte dhunuar përpara se ta lironte. Në fillim policia e mohoi dhunimin dhe në një deklaratë ditën e mëpasshme pohoi se e kishin shoqëruar Balltën për pak orë pasi ai nuk kishte pranuar të identifikohej. Policia e shtetit më pas pezulloi punonjësin që supozohej të ketë kryer sulmin dhe nisi hetim disiplinor kundër tij.

Censura dhe kufizimet e përmbajtjes: Gazetarët u ankuan se botuesit dhe redaktorët censuruan punën e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në përgjigje të presionit politik dhe të biznesit. Shumë gazetarë u ankuan se mungesa e kontratave të punësimit shpesh kufizonte mundësinë e tyre për të raportuar objektivisht dhe i nxiste të praktikonin vetë-censurim.
Unioni i Gazetarëve Shqiptarë tha në shtator se 75 për qind e grupeve mediatike të vendit kishin vonesa nga dy deri në katër muaj në dhënien e pagave mujore të gazetarëve. Këto vonesa bënë që më shumë gazetarë t'u ktheheshin burimeve të jashtme për më shumë të ardhura, gjë e cila krijoi njëanshmëri në raportimin e tyre.

Transmetuesit dhe botuesit u ankuan se qeveria përdori blerjet e reklamave për të ndikuar raportimin e grupeve mediatike. Reklamuesit privatë bënë të njëjtën gjë për shkak të frikës së inspektimit të taksave.

Ligji për shpifjen/Siguria kombëtare: Ligji garanton mbrojtje të veçantë për zyrtarë qeveritarë vendas dhe të huaj në raste shpifjesh; megjithatë, ligji ndalon fyerjen dhe botimet e qëllimshme për informacion të rremë si kundravajtje të ndjekura privatisht dhe këto janë objekt gjobe. Disa grupe mediatike vazhduan të prodhonin shkrime investigative të cilat me raste çuan në shkarkime dhe çështje penale kundër zyrtarëve të korruptuar.

Në vitin 2012 Gjykata e Rrethit Tiranë gjobiti televizionin Top Channel me 51 milion lekë (489.300 dollarë) për transmetimin në vitin 2009 të një materiali me kamera të fshehta që çoi në shkarkimin e ish Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ylli Pango. Gjykata e Apelit e ktheu vendimin. Gjykata e Lartë vendosi që çështja të kthehej në gjykatën e rrethit. Avokatët e Pangos e apeluan vendimin dhe Gjykata e Lartë nuk e kishte shqyrtuar ende çështjen deri në tetor.

Liria e Internetit
Nuk pati kufizime nga qeveria në lidhje me përdorimin e internetit as raportime që qeveria të ketë monitoruar postën elektronike apo sallat e bisedimeve në internet pa autoritetin e duhur ligjor. Sipas të dhënave të hartuara nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit, përafërsisht 55 për qind e popullsisë përdorte internetin në vitin 2012. Numri i individëve të pajtuar në internet në pajisje të lëvizshme me valë të gjera në vitin 2012 arriti në 18 për qind, ndërsa numri i personave të pajtuar në internet fiks në 2012 ishte 5 për qind. Linja fikse ishte e përqendruar kryesisht në zonat urbane.

Liria akademike dhe ngjarjet kulturore
Nuk pati kufizime nga qeveria për lirinë akademike dhe ngjarjet kulturore; megjithatë pati korrupsion të përhapur në institucionet arsimore, përfshirë universitetet publike dhe shpesh ky korrupsion ndikonte në rezultatet e studentëve. Shumë studentë u ankuan se mësuesit kërkonin ryshfete për të dhënë nota kaluese, duke e bërë kështu të vështirë për disa studentë të siguronin arsimin e lartë.

b. Liria për grumbullim paqësor dhe formimi i shoqatave
Kushtetuta dhe ligji sigurojnë lirinë e grumbullimit dhe në përgjithësi qeveria e respektoi këtë.

Përpara zgjedhjeve të 23 qershorit disa mbështetës partiakë raportuan se policia kishte ngacmuar pjesëmarrës ose kishte ndaluar ata të bënin protesta publike. ODHIR-i raportoi se liritë thelbësore u respektuan dhe se të gjithë pjesëmarrësit në garë patën mundësinë të bënin fushatë të lirë.

Liria për krijimin e shoqatave
Kushtetuta dhe ligji sigurojnë lirinë e grupimit në shoqata dhe në përgjithësi qeveria e respektoi këtë liri.

c. Liria e besimit fetar

Shikoni *Raportin Ndërkombëtar për Lirinë e Fesë* nga Departamenti i Shtetit në faqen e internetit: www.state.gov/j/drl/irf/rpt/.

d. Liria e lëvizjes, personat e zhvendosur brenda vendit, mbrojtja e refugjatëve dhe personat pa shtetësi

Kushtetuta dhe ligji sigurojnë lirinë për lëvizje të brendshme, udhëtime jashtë vendit, emigrim dhe riatdhesim, e në përgjithësi qeveria i respektoi këto të drejta. Qeveria bashkëpunoi me Zyrën e Komisionerit të Lartë për Refugjatët të OKB-së (UNHCR) dhe organizata të tjera humanitare për t'u siguruar mbrojtje dhe ndihmë refugjatëve, refugjatëve të kthyer, azilkërkuesve, personave pa shtetësi dhe personave të tjerë të lidhur me këto kategori.

Lëvizja brenda vendit: Migrantët e brendshëm duhet të transferojnë të dhënat e tyre civile në komunitetin e ri ku vendosen për banim në mënyrë që të përfitojnë shërbime shtetërore si edhe duhet të provojnë se janë të strehuar ligjërisht nëpërmjet pronësisë së banesës, kontratës së qerasë, ose faturave të shërbimeve. Shumë persona nuk kanë mundur të japin këto prova dhe si rrjedhojë nuk kanë mundur të përfitojnë shërbimet thelbësore. Shtetas të tjerë nuk kishin regjistrim formal në komunitetet ku banonin, veçanërisht pjesëtarë të komunitetit rom dhe egjiptiano-ballkanikë. Ligji nuk e ndalon regjistrimin e tyre por shpesh ishte e vështirë të bëhej.

Mbrojtja e refugjatëve

Mundësia për azil: Ligji siguron dhënie azili apo status refugjati dhe qeveria ka krijuar një sistem që u ofron mbrojtje refugjatëve. Nuk ka kufij kohorë për të kërkuar azil, por ligji parashikon që qeveria të marrë vendim në lidhje me dhënie azili ose jo brenda 101 ditësh nga kërkesa fillestare. Qeveria në përgjithësi veproi në përputhje me kërkesat.

Vend i sigurt origjine/Tranzit: Ligji ndalon individët me origjinë nga vende të sigurta të aplikojnë për azil apo status refugjati. Nuk pati ankesa të besueshme që azilkërkues të jenë dërguar në vende me sisteme azili që nuk funksionojnë si duhet.

Zgjidhje të përhershme: Në maj qeveria ra dakord të pranonte 210 muxhahedinë nga Iraku, të cilët i klasifikoi si azilkërkues. Qeveria risistemoi 196 prej tyre pranë Tiranës deri në tetor. Qeveria ndihmoi në kthimin e sigurt me vullnetin e tij të një refugjati nga Egjipti dhe një nga Tunizia.

Mbrojtja e përkohshme: Qeveria gjithashtu dha mbrojtje të përkohshme për individë që nuk mund të plotësonin kushtet për refugjatë. Qeveria raportoi se nuk pati refugjatë që kërkonin mbrojtje të përkohshme gjatë vitit.

Personat pa shtetësi

Në vitin 2011 UNHCR-ja raportoi 7.443 persona pa shtetësi në vend.

Seksioni 3. Respektimi i të drejtave politike: E drejta e shtetasve për të ndryshuar qeverinë e tyre

Kushtetuta u njeh shtetasve të drejtën të ndryshojnë qeverinë e tyre në mënyrë paqësore, dhe shtetasit e ushtruan këtë të drejtë nëpërmjet zgjedhjeve periodike bazuar në të drejtën universale të votës.

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Zgjedhjet e fundit: Më 23 qershor vendi zhvilloi zgjedhje parlamentare të përshkruara nga misioni i OSBE/ODIHR-it si "shumë konkurruese, me pjesëmarrje aktive të shtetasve gjatë gjithë fushatës dhe në respektim të pastër të të drejtave themelore." Megjithatë, OSBE-ja vërejti gjithashtu se atmosfera e mosbesimit mes dy forcave politike kryesore njollosi mjedisin zgjedhor

dhe ishte sfidë për administrimin e gjithë procesit zgjedhor." Misioni i vëzhgimit citoi gjithashtu problem me parregullsi procedurale dhe raste përputhjeje të pavend mes institucioneve shtetërore dhe interesave partiake.
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) veproi pa numrin e domosdoshëm për vendimmarrje gjatë gjithë procesit të zgjedhjeve për shkak të bojkotit të opozitës pasi kryeministri shkarkoi në mënyrë të diskutueshme një prej anëtarëve të këtij komisioni. OSBE-ja raportoi se përshtypja e përgjithshme mes njerëzve ishte se KQZ-ja veproi në mënyrë politike, gjë e cila krijoi një ndjesi të përgjithshme mosbesimi në publik.

Pjesëmarrja e grave dhe minoriteteve: Ligji urdhëron që gratë të përbëjnë 30 për qind të pozicioneve të emëruara dhe të zgjedhura, dhe kodi zgjedhor siguron që 30 për qind e kandidatëve të jenë gra. Kodi zgjedhor nuk u zbatua nga të gjitha partitë dhe gjobat për moszbatim ishin të ulëta. Në 11 maj KQZ-ja gjobiti Partinë Demokratike, Partinë Socialiste dhe Lëvizjen Socialiste për Integrim për veprim në mospërputhje me kuotat e vendosura ligjërisht në listat e kandidatëve të tyre për zgjedhjet parlamentare të qershorit. U zgjodhën 25 gra në kuvendin 140-vendësh në zgjedhjet e 23 qershorit, një rritje nga 22 në parlamentin e mëparshëm. Numri i ministreve femra në qeverinë e re u shtua në gjashtë krahasuar me një që ishte në qeverinë e mëparshme.
Kërkesat për dokumente regjistrimi dhe mungesa e identifikimit në popullsinë rome vështirësoi pjesëmarrjen e romëve në zgjedhjet e 23 qershorit. Media publikoi raportime përpjekjesh për të konfiskuar identifikimin e votuesit mes votuesve romë në këmbim të parave apo ushqimit të dhëna përpara zgjedhjeve. Nuk pati romë të zgjedhur në parlament apo në pozicione ministrash e zëvendësministrash. Disa anëtarë të pakicave greke të cilët vinin nga parti të ndryshime politike u zgjodhën në parlament; një figurë e njohur nga një parti që përfaqëson pakicat greke u zgjodh nënkryetar i parlamentit.

Seksioni 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në qeveri
Ligji parashikon ndëshkime penale për korrupsion nga zyrtarët; megjithatë, qeveria nuk e zbatoi si duhet ligjin dhe shpesh zyrtarët ishin të përfshirë në praktika korruptive pa u ndëshkuar.

Korrupsioni: Korrupsioni ishte i përhapur në të gjitha degët e qeverisë. Nga janari deri në qershor, Njësitë e Përbashkëta Hetimore, njësi nga shumë agjenci që hetojnë dhe ndjekin penalisht korrupsionin dhe krimet e tjera financiare nisën 651 hetime të reja dhe dërguan 230 çështje në gjykatë. U përfunduan gjykimet për 82 çështje duke dhënë vendime fajësimi për 122 të pandehur dhe rrëzim akuze për 19 të pandehur. Deri në qershor 275 individë ishin akoma në proces gjykimi.
Në 24 tetor gjykata dënoi ish prokurorin Sandër Plepi me një vit heqje lirie për ndikim të paligjshëm mbi bashkëshorten e tij Marsela Balili, gjyqtare në të njëjtën gjykatë rrethi por liroi bashkëshorten.

Në vitin 2012 bashkërendimi i përgjithshëm i çështjeve kundër korrupsionit iu ngarkua Departamentit të Auditimit dhe Kontrollit të Brendshëm në zyrën e kryeministrit. Ky departament kreu një sërë hetimesh nga ana e tij për ankesa korrupsioni por nuk lëshoi raporte të qenësishme dhe nuk i referoi asnjë rast prokurorisë. Përgjithësisht u konsiderua si joefikas.

Sektori për Krimin dhe Korrupsionin në Policinë e Shtetit Shqiptar hetoi çështje korrupsioni. Hetimet e këtij sektori u penguan nga kapaciteti i kufizuar për hetime dhe mbikëqyrje të fshehta. Agjenci të tjera, përfshirë autoritetet e taksave dhe doganave, dhe audituesit e rregulluesit e shtetit kryejnë gjithashtu hetime kundër korrupsionit. Përpjekjet e tyre, si edhe përpjekjet e policisë së shtetit, u penguan nga rrjedhje informacioni gjatë hetimit, presioni politik i vërtetë dhe i perceptuar dhe sistemi i rastësishëm i riemërimeve.

Ndjekjet ligjore u shqyrtuan nga Prokuroria e Përgjithshme nëpërmjet Njësive të Përbashkëta të Hetimit. Kishte shtatë njësi në qytetet më të mëdha të vendit. Njësitë përparuan dukshëm në ndjekjet e korrupsionit publik në nivelet e ulëta por ndjekja e krimeve të niveleve të larta mbeti e pakapshme për shkak të frikës së hetuesve nga ndëshkimi, mungesa e përgjithshme e burimeve dhe korrupsioni gjyqësor.

Agjencitë e zbatimit nuk bashkëpunuan në mënyrë aktive dhe të qëndrueshme me shoqërinë civile në shumicën e rasteve. Agjencitë e zbatimit kishin burimet të mjaftueshme. Këto agjenci bashkëpunuan në raste të përzgjedhura të sjella në vëmendjen e tyre nga aktorë ndërkombëtarë, në shumë raste me kërkesën e shoqërisë civile. Përdorimi i sloganeve nga ana e qeverisë që nxitnin "tolerancën zero" për korrupsionin shpesh ndrydhte raportimin dhe nxiste manipulimin e të dhënave që tregonin se korrupsioni nuk ekzistonte.

Autoritetet shkarkuan disa zyrtarë të qeverisë të cilët qartazi ishin përfshirë në raste abuzimi por iu dhanë atyre poste të tjera në qeveri pa ndonjë ndëshkim. Mbeti problematike ndjekja penale e zyrtarëve të lartë dhe të pandehurit me pozitë shpesh dilnin të pafajshëm edhe përballë provave më se të qarta.

Mbrojtja e informatorit: Ligji nuk jep mbrojtje për informatorët.

Deklarimi i pasurisë: Ligji kërkon që zyrtarët e lartë të deklarojnë pasuritë e tyre në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP), i cili i monitoron dhe verifikon këto deklarime. ILDKP-ja i bëri publike këto deklarata. Ligji siguronte që ILDKP-ja të gjobiste zyrtarët që nuk u përmbaheshin kërkesave të deklarimit. Deri në tetor ILDKP-ja gjobiti 252 individë për vonesën e dorëzimit të deklaratave dhe për konflikt interesi.
Në tetor, stafi i ILDKP-së ngriti akuza penale kundër inspektores së përgjithshme Zana Xhuka, duke e akuzuar Xhukën për vjedhje të fondeve publike, manipulim të deklarimeve të pasurisë dhe keqpërdorim të personelit. Xhuka pretendonte se akuzat ishin bërë mbi motive politike.

Marrja e informacionit nga publiku: Ligji garanton që publiku të mund të marrë informacione qeveritare, por qeveria nuk e zbatoi si duhet këtë ligj. Procesi për publikimin e informacionit shpesh nuk ishte i qartë dhe me raste zyrtarët nuk ishin të gatshëm të nxirrnin informacionin. Ligji përcakton se e drejta për të marrë informacion mund të kufizohet kur informacioni kategorizohet si i klasifikuar apo kur nxjerrja e informacionit dhunon mbrojtjen e të dhënave personale. Ligji përcakton afat kohor prej 40 ditësh që institucionet përgjegjëse publike të japin informacionin e kërkuar. Shumica e ministrive dhe agjencive të qeverisë postuan informacionin publik në faqet e tyre të internetit; megjithatë, bizneset dhe shtetasit u ankuan për mungesë transparence dhe mospublikim të disa rregullave dhe ligjeve që përbëjnë informacion publik

bazë. Shpesh shtetasit u përballën me probleme serioze në marrjen e informacioneve të tilla. Në përgjithësi, marrja e informacionit të qeverisë është pa pagesë, por ka raste të caktuara kur kërkohen tarifa përpunimi për të mbuluar koston e shërbimit që i kushton institucionit të japë informacionin. Veprimi në mospërputhje me këtë të drejtë është i ndëshkueshëm si shkelje administrative dhe jo penale. Shtetasit mund të apelojnë refuzimin e informimit tek autoritetet ku bënë kërkesën fillestare ose në një gjykatë civile.

Seksioni 5. Qëndrimi i qeverisë në lidhje me hetimet ndërkombëtare dhe joqeveritare të dyshimeve për dhunim të të drejtave të njeriut

Disa grupe vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut vepruan në përgjithësi pa kufizime nga qeveria, me hetime dhe publikime të zbulimeve të tyre në lidhje me çështje të të drejtave të njeriut. Zyrtarë të qeverisë në përgjithësi bashkëpunuan dhe iu përgjigjën këndvështrimeve të tyre.

Organizma qeveritare të të drejtave të njeriut: Zyra e Avokatit të Popullit është institucioni kryesor i të drejtave të njeriut për nxitjen dhe zbatimin e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit ka autoritetin të kontrollojë mjediset e paraburgimit dhe burgjet dhe të hapë çështje ku viktima nuk mund të dalë vetë. Edhe pse Avokati i Popullit nuk pati fuqinë të zbatonte vendimet, ai ka vepruar si monitorues për dhunime të të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit raporton në parlament një herë në vit.

Kuvendi ka një komision për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut. Megjithatë, ky komision ishte joefikas për problemet e të drejtave të njeriut dhe deri në shtator nuk iu përgjigj kërkesave për t'u takuar me Avokatin e Popullit.

Rastet e diskriminimit mund të sillen përpara komisionerit të qeverisë për çështjet kundër diskriminimit. Megjithatë, zyra e komisionerit u përqendrua kryesisht në fushata mbështetjeje dhe ndërgjegjësimi, e vuri shumë pak sanksione kundër zyrtarëve të qeverisë. Ligji lejon komisionerin kundër diskriminimit të dëshmojë si dëshmitar ekspert edhe në apelime të çështjeve që ka refuzuar zyra. U paraqitën dy çështje në gjykatë që testonin zbatimin e ligjit. Gjykata vendosi se kishte patur diskriminim në një rast, i cili ishte në apelim deri në fund të vitit, dhe deri në tetor gjykata nuk kishte nxjerrë asnjë vendim për rastin e dytë.

Seksioni 6. Diskriminimi, abuzimet shoqërore dhe trafikimi i personave

Ligji ndalon diskriminimin në bazë race, gjinie, moshe, paaftësie, gjuhe, besimi fetar, identiteti gjinor dhe/ose orientimi seksual, shëndeti, familjeje, statusi ekonomik apo social. Megjithatë, qeveria nuk i zbatoi si duhet këto ndalime.

Gratë

Përdhunimi dhe dhuna në familje: Kodi penal dënon përdhunimin, përfshirë atë nga bashkëshorti, por qeveria nuk i zbatoi si duhet këto ligje. Viktimat rrallë raportuan abuzimin nga bashkëshorti dhe zyrtarët nuk ndoqën ligjërisht përdhunimin nga bashkëshorti. Nuk ishte përcaktuar mirë koncepti i përdhunimit nga bashkëshorti dhe shpesh autoritetet dhe publiku nuk e konsideronin atë si krim. Ligji vendos dënime për përdhunimin dhe sulmin ndaj personit në varësi të moshës së viktimës. Për përdhunimin e një të rrituri parashikohet dënim me burg nga tre deri në 10 vjet; për përdhunim adoleshenti nga mosha 14 deri në 18 vjeç dënimi shkon nga pesë

deri në 15 vjet dhe për përdhunimin e një të mituri nën 14 vjeç dënimi është nga shtatë deri në 15 vjet.
Dhuna në familje kundër grave, përfshirë abuzimin nga bashkëshorti vazhdoi të ishte problem serioz. Deri në tetor policia raportoi 2.130 raste dhune në familje, krahasuar me 1.860 raste gjatë së njëjtës periudhë në vitin 2012. Qeveria ngriti akuza në 825 raste, krahasuar me 593 raste gjatë së njëjtës periudhë në vitin 2012. Gjykatat nxorën 1.306 urdhra kufizimi deri në tetor, krahasuar me 1.146 urdhra të nxjerra gjatë së njëjtës periudhë në vitin 2012. Policia raportoi marrjen e 2.515 ankesave të lidhura me dhunën në familje nëpërmjet linjës së tyre telefonike të urgjencës deri në tetor, krahasuar me 1.405 ankesa të marra gjatë së njëjtës periudhë në vitin 2012. Policia shpesh nuk kishte trajnimin ose kapacitetin e duhur për t'u marrë me rastet e dhunës në familje.

Ministria e Rinisë dhe Mirëqenies Sociale merret me çështjet e grave, përfshirë dhunën në familje. Streha qeveritare për viktimat e dhunës në familje në Tiranë ndihmoi 27 gra dhe 27 fëmijë deri në nëntor. Megjithatë, streha nuk mund të pranonte viktima pa urdhër gjykate. OJQ-të patën nën kontroll tre qendra për mbrojtjen e viktimave nga dhuna në familje, një në Tiranë dhe dy jashtë kryeqytetit.

Ngacmimi seksual: Ligji ndalon ngacmimin seksual; megjithatë, zyrtarët rrallë e zbatuan ligjin. OJQ-të besojnë se ngacmimi seksual mbeti tejet i pa raportuar.

Të drejtat riprodhuese: Çiftet dhe individët kanë të drejtë të vendosin të lirë dhe me përgjegjësinë e tyre numrin e fëmijëve, distancën kohore mes fëmijëve dhe kohën kur do të kenë fëmijë dhe kanë të drejtë të kenë informacionin dhe mjetet për ta zbatuar këtë të lirë nga diskriminimi, detyrimi apo dhuna. Sipas ligjit u jepet kujdes shëndetësor të gjithë shtetasve. Megjithatë, cilësia dhe marrja e kujdesit shëndetësor, përfshirë atë obstetrik dhe pas lindjes, nuk ka qenë i kënaqshëm veçanërisht në zonat rurale. Sipas Studimit Demografik dhe Shëndetësor, vetëm 11 për qind e popullsisë përdorte metoda kontraceptive moderne. Për të shqyrtuar këto çështje Ministria e Shëndetësisë nisi një strategji të re planifikimi familjar me ndihmën e Fondit të Kombeve të Bashkuara mbi Popullsinë (UNFPA) për periudhën 2012-2016. Strategjia synonte të rriste kërkesën dhe mundësinë e përdorimit të shërbimeve cilësore për kujdesin e shëndetit riprodhues dhe planifikimit familjar nëpërmjet rritjes së përdorimit të kontraceptivëve, të ulte numrin e shtatzënive të padëshiruara dhe të përmirësonte shëndetin e nënës dhe foshnjeve.

Diskriminimi: Ligji siguron të drejta të barabarta për burrat dhe gratë bazuar në ligjin e familjes dhe ligjin e pronës si dhe në sistemin gjyqësor. Gratë nuk u përjashtuan nga profesione të caktuara as me ligj e as në praktikë, por ishin të nënpërfaqësuara në nivelet më të larta në fushat e tyre. Edhe pse ligji përcakton pagë të barabartë për punë të barabartë, qeveria dhe punëdhënësit nuk e zbatuan tërësisht këtë dispozitë. Në shumë komunitete gratë ishin objekt i diskriminimit social si rezultat i normave sociale tradicionale që i konsideronin gratë nën varësinë e burrave.

Përzgjedhja mbi bazë gjinore: Një studim i vitit 2012 nga World Vision dhe UNFPA deklaroi se mund të ketë përzgjedhje mbi bazë gjinore megjithëse ishte e vështirë të merreshin të dhëna të sakta.

Fëmijët

Regjistrimi i lindjes: Nënshtetësia vjen automatikisht me lindjen brenda territorit të vendit ose si trashëgimi nga njëri prind. Në përgjithësi prindërit inkurajohen të regjistrojnë lindjen e fëmijës së tyre brenda afateve kohore. Jepet një shpërblim monetar për regjistrimet e bëra deri në 60 ditë pas lindjes për të nxitur më tej regjistrimin e hershëm. Nuk pati raportime diskriminimi në regjistrimin e lindjes. Megjithatë kërkesat e vendbanimit për regjistrim e vështirësuan regjistrimin e fëmijëve për prindërit nga komuniteti rom dhe egjiptiano-ballkanik dhe mundësinë për të përfituar disa shërbime të tjera qeveritare që vareshin nga regjistrimi.
Sipas Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), fëmijët e lindur nga migrues të brendshëm apo ata që janë kthyer nga jashtë shtetit shpesh nuk kishin certifikata lindjeje apo dokumente të tjera ligjore dhe si rrjedhojë nuk mundën të ndiqnin mësimet në shkollë. Ky problem hasej veçanërisht në familjet rome në të cilat çiftet shpesh martoheshin në moshë të re dhe nuk regjistronin lindjen e fëmijëve të tyre.

Arsimi: Ligji parashikon arsim falas për nëntë vjet dhe autorizon shkollat private. Ndjekja e shkollës është e detyruar deri në klasën e nëntë ose në moshën 16 vjeç, cilado vjen më herët. Shumë fëmijë lanë shkollën më parë se e lejonte ligji për të punuar për familjet e tyre, veçanërisht në zonat rurale. Prindërit duhet të blejnë mjetet, librat, uniformat dhe ngrohësit për disa klasa, të cilat kushtojnë tej mase për shumë familje, veçanërisht për romët dhe pakicat e tjera. Shumë familje u shprehën gjithashtu se këto shpenzime ishin shkaku përse nuk i dërgonin vajzat në shkollë. Megjithëse qeveria ka program për dhënien e librave falas për familjet me të ardhura të ulëta, shumë familje dhe OJQ raportuan se nuk ishin në gjendje të merrnin tekste falas.

Abuzimi me fëmijët: Kanë ndodhur abuzime me fëmijët, përfshi abuzimin seksual, edhe pse viktimat rrallë e kanë raportuar këtë. CRCA raportoi se 58 për qind e fëmijëve ishin viktima të abuzimit fizik, 11 për qind e fëmijëve ishin viktima të ngacmimit seksual dhe thuajse 5 për qind e fëmijëve raportuan se kishin qenë viktima të abuzimit seksual. Pothuajse 70 për qind e fëmijëve raportuan abuzim psikologjik nga anëtarë të familjes, sipas CRCA-së.

Martesa e hershme dhe me detyrim: Mosha e lejuar për martesë është 18 vjeç. Martesat nën moshë ndodhnin kryesisht në zonat rurale dhe brenda komuniteteve rome. Sipas statistikave të UNFPA të vitit 2009, 9.6 për qind e femrave nga mosha 20 deri në 24 ishin martuar pa mbushur moshën 18 vjeç. UNFPA raportoi se në vitin 2011, 31 për qind e vajzave nga 13 deri në 17 vjeç nga komuniteti rom ishin të martuara. Disa OJQ raportuan se martesat e hershme dhe të detyruara kishin ndodhur në komunitete rurale si pjesë e skemave të trafikimit njerëzor, kur prindërit pranonin që vajzat e tyre nën moshë të martoheshin me burra të huaj më të mëdhenj në moshë, të cilët më pas i trafikonin ato në vende të tjera.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Në disa raste fëmijët nën moshën 18 vjeç u shfrytëzuan për prostitucion. Dënimet për shfrytëzim seksual të fëmijëve për përfitim variojnë nga gjoba deri në 15 vjet heqje lirie. Vendi ka ligj për përdhunimin dhe mosha e lejueshme për marrëdhënie seksuale me dëshirë është 14 vjeç. Dënimi për dhunim seksual të fëmijës nën moshën 14 vjeç është heqje lirie nga pesë deri në 15 vjet. Ligji ndalon bërjen dhe shpërndarjen e pornografisë me fëmijë; dënimet janë me gjobë nga një milion deri në pesë milion lekë (9.590 to 47.950) dhe dënim me burg nga një deri në pesë vjet. Në maj, me informacionin e OJQ-ve dhe Avokatit të

Popullit, parlamenti miratoi ligjin që dënon zotërimin e pornografisë me fëmijë. Ligjet në lidhje me përdhunimin dhe shfrytëzimin seksual të të miturve përgjithësisht u zbatuan mirë; megjithatë OJQ-të raportuan se ligjet për pornografi me fëmijë rrallë u zbatuan.

Fëmijët e zhvendosur: Fëmijët e zhvendosur dhe ata të rrugës mbetën problem, veçanërisht brenda komunitetit rom. Fëmijët e rrugës lypnin ose bënin punë të vogla, disa migruan në vendet fqinje veçanërisht gjatë verës. Këta fëmijë ishin më të ekspozuarit ndaj rrezikut të trafikimit, dhe disa prej tyre u bënë viktima trafikimi. Disa fëmijë të dëbuar u përdorën nga bandat kriminale për të vjedhur shtëpi sepse ligji ndalon ndjekjen penale të fëmijëve nën moshën 14 vjeç për dhunim banese. U hetuan shumë pak raste trafikimi fëmijësh.

Fëmijët në institucione përkujdesjeje: Nuk pati raportime që jetimët e larguar nga kujdestaria e shtetit në moshë të rritur të jenë përballur me sfida të mëdha për të gjetur strehim dhe shërbime të përshtatshme.

Rrëmbimet ndërkombëtare të fëmijëve: Vendi bën pjesë në Konventën e Hagës të vitit 1980 mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve. Për informacion të mëtejshëm shikoni raportin e Departamentit të Shtetit mbi nivelin e përmbushjes në faqen e internetit:www.travel.state.gov/abduction/resources/congressreport/congressreport_4308.html.

Antisemitizmi

Raportohet të kenë qenë vetëm disa qindra hebrenj në vend. Nuk pati raportime për akte antisemitizmi

Trafikimi i personave

Shikoni *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në faqen e internetit: www.state.gov/j/tip/.

Personat me aftësi të kufizuara

Kushtetuta dhe ligjet ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore të kufizuara në punësim, arsimim, transport, mundësi shfrytëzimi të kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve të tjera shtetërore sipas ligjit. Pavarësisht këtyre parashikimeve ligjore, punëdhënësit, shkollat, institucionet e kujdesit shëndetësor dhe ofruesit e shërbimeve të tjera shtetërore në disa raste kanë diskriminuar persona nga këto kategori aftësish të kufizuara. Ligji urdhëron ndërtesat e reja publike të kenë mundësi shfrytëzimi nga personat me aftësi të kufizuara por qeveria e ka zbatuar këtë ligj në mënyrë josistematike. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, 24 për qind e personave me aftësi të kufizuara nuk kishin ndjekur asnjëherë shkollën dhe 65 për qind e këtyre ishin femra. Varfëria e përhapur, kushtet e parregulluara të punës dhe kujdesi i dobët mjekësor përbënin probleme të rënda për shumë persona me aftësi të kufizuara.

Personat me aftësi të kufizuara nuk janë penguar të marrin pjesë në çështje qytetare, megjithëse kufizimet në burime dhe mungesa e infrastrukturës e kanë vështirësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë në shumë aktivitete. Qeveria ngriti agjenci për shërbime sociale në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, por këto agjenci shpesh nuk kishin fonde për zbatimin e programeve të tyre. Ligji nuk kufizon të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të votojnë; megjithatë qendrat e votimit shpesh ishin vendosur në mjedise me mungesë akomodimesh për persona të tillë, duke minuar në këtë mënyrë të drejtat e tyre për të votuar. Gjatë zgjedhjeve të 23

qershorit, shumë qendra votimesh ishin vendosur në katet e larta të shkollave dhe ndërtesave publike pa mundësi arritjeje për votues me aftësi të kufizuara.

Avokati i Popullit rregullisht ka inspektuar institucionet e shëndetit mendor. Pranimi dhe nxjerrja e pacientëve në institucione të shëndetit mendor ishte problem për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të dhënë vlerësime të sakta psikiatrike.

Pakicat kombëtare/racore/etnike

Pati raportime për diskriminim të konsiderueshëm shoqëror kundër anëtarëve të komuniteteve rome dhe egjiptiano-ballkanike. Romët dhe egjiptiano-ballkanikët u përballën me diskriminim në lidhje me banesat, punësimin, kujdesin shëndetësor dhe arsimin. Disa shkolla hezituan të pranonin nxënës romë dhe egjiptiano-ballkanikë, për më tepër kur këta ishin edhe të varfër. OJQ-të vendase raportuan se shumë shkolla që pranuan nxënës romë i linin ata mënjanë në klasa, me raste edhe duke i ndarë fizikisht nga pjesa tjetër e nxënësve.

Në gusht një investitor në prona private në Tiranë nxori me forcë 37 familje rome nga një ndërtesë që ata kishin zënë prej 10 vitesh. Familjet dolën në rrugën përpara ndërtesës. Bashkia e Tiranës nuk iu përgjigj thirrjeve të tyre për ndihmë me strehimin. Pushteti qendror identifikoi një strehë për familjet në një ish bazë ushtarake të rinovuar dhe familjet u vendosën atje.

Ligji siguron status zyrtar pakice për grupet kombëtare dhe më vete për grupet etnike-gjuhësore. Qeveria përkufizon grekët, maqedonasit dhe malazezët si grupe kombëtare ku grekët përbëjnë grupin më të madh. Ligji përkufizon arumunët (vllehët) dhe romët si grupe pakicash etnike-gjuhësore.

Pakicat etnike greke u ankuan për mosgatishmërinë e qeverisë t'u njohë qyteteve etnike greke jashtë "zonës së pakicës" përcaktuar nga regjimi komunist përdorimin e gjuhës greke në dokumente zyrtare dhe shenja publike në zona etnike greke, dhe të përfshijnë një numër më të lartë grekësh etnikë në administratën publike

Abuzimet shoqërore, diskriminimi dhe aktet e dhunës bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor

Ligji ndalon diskriminimin e individëve lezbikë, gei, biseksualë dhe transgjinorë (LGBT). Komisioneri i qeverisë kundër diskriminimit regjistroi disa ankesa nga individë dhe organizata LGBT. Komisioneri nxori sanksione kundër dy politikanëve të lartë; megjithatë, politikanët i shpërfillën këto sanksione. Zbatimi i ligjit në përgjithësi ishte i dobët.

Në maj, Kuvendi miratoi një amendim i cili shtoi orientimin seksual dhe identitetin gjinor në listën e grupeve të mbrojtura nga ligji kundër diskriminimit. Në prill kryeministri Sali Berisha u takua publikisht me aktivistë të grupit LGBT dhe përsëriti mbështetjen e tij për të drejtat e tyre njerëzore dhe përfshirjen e tyre në shoqëri. Më pas, në maj, kryetari i opozitës dhe kryeministri i tanishëm Edi Rama u takua gjithashtu publikisht me aktivistë të grupit LGBT në një ngjarje tejet të reklamuar në të cilën ai i dha zë mbështetjes së tij për këtë komunitet.

Pavarësisht ligjit dhe mbështetjes formale të qeverisë për të drejtat e grupit LGBT, pati qëndrime homofobike. Në 11 prill media publikoi një mesazh privat në celular që pretendohej t'i ishte dërguar nga ish ministri i drejtësisë Eduard Halimi deputetit të Partisë Demokratike Fatos Hoxha

gjatë paraqitjes së Avokatit të Popullit në një takim parlamentar. Në atë sms ai paralajmëronte zotin Hoxha të "mos përzihej me Avokatin e Popullit se ai mbështet pederastët."

Në 17 maj aktivistët morën pjesë në një Pedalim Kundër Homofobisë, një xhiro e shkurtër me biçikleta në bulevardin kryesor të Tiranës. Një grup burrash i sulmoi aktivistët në grumbullimin pas aktivitetit, duke u hedhur atyre gaz lotsjellës në kafenenë ku ata ishin mbledhur, duke lëshuar britma sharjesh e ofendimesh. Policia nuk pranoi ta quante këtë si krim urrejtjeje duke deklaruar se nuk ishte lënduar fizikisht asnjë pjesëmarrës.

Forma të tjera dhune dhe diskriminimi shoqëror
Ligji ndalon diskriminimin e personave me HIV/SIDA. Ekziston një ndjenjë e përgjithshme stigme shoqërore kundër personave me HIV/SIDA edhe pse nuk pati raportime për dhunë kundër personave të tillë gjatë vitit.

Seksioni 7. Të drejtat e punëtorëve
a. Liria e grupimit në shoqata dhe e drejta për marrëveshje kolektive
Ligji dhe rregullorja e statutet lidhur me të japin të drejtën për shumicën e punonjësve të formojnë unione të pavarura, të kryejnë greva të ligjshme dhe të bëjnë marrëveshje kolektive. Qeveria i ka zbatuar këto ligje në mënyrë efikase. Ligji ndalon anëtarët e ushtrisë dhe zyrtarët e lartë të qeverisë të jenë pjesë e sindikatave dhe kërkon që një sindikatë të ketë së paku 20 anëtarë në mënyrë që të mund të regjistrohet. Ligji siguron të drejtën e grevës për të gjithë punonjësit me përjashtim të ushtarakëve në uniformë, policisë, personelit të domosdoshëm mjekësor dhe spitalor, personave që merren me kontrollin e trafikut ajror dhe shërbimeve të burgjeve, si edhe punonjësve të domosdoshëm ose jo të ndërmarrjeve të ujësjellësit dhe ato elektrike. Punonjësit që nuk ishin pjesë e përjashtimit nga ky ligj kanë ushtruar të drejtën e tyre për të bërë grevë.

Ligji ndalon diskriminimin kundër sindikatave dhe siguron rikthimin e punonjësve të pushuar nga puna për shkak të aktivitetit me sindikatën. Këto ligje rrallë ofronin mbrojtje për punonjësit shtëpiakë apo migrantët.

Punonjësit civilë në të gjitha fushat kanë të drejtën kushtetuese të organizohen e të bëjnë marrëveshje kolektive dhe ligji përcakton procedurat për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve kolektive. Sindikatat që përfaqësojnë punonjës të sektorit publik kanë bërë marrëveshje drejtpërdrejt me qeverinë. Mbeti e vështirë arritja e marrëveshjeve të frytshme kolektive dhe ishte e vështirë të viheshin në zbatim marrëveshjet e bëra. Sindikatat shpesh janë të lidhura me partitë politike, dhe me raste grevat merrnin tone politike. Ligji ndalon grevat që gjykohen nga gjykata të kenë natyrë politike.

Ekziston një inspektorat pune por nuk pati raportime për gjoba arbitrare apo zbatime joefikase.

b. Ndalimi i punës me forcë apo të detyruar
Ligji ndalon të gjitha format e punës së detyruar apo me forcë. Megjithatë qeveria nuk e zbatoi si duhet këtë ligj gjatë gjithë kohës. Zbatimi u pengua për shkak të mungesës së bashkërendimit mes ministrive dhe zbatimit të parregullt të procedurave standarde të veprimit. Në shtator qeveria e re emëroi një koordinator të ri kombëtar për anti-trafikimin. Zyra e Koordinatorit Kombëtar të

Antitrafikut ishte tërësisht e varur nga fondet e dhuruesve ndërkombëtarë për mbështetjen e operacioneve të saj.

Shikoni gjithashtu *Raportin mbi Trafikimin e Personave* nga Departamenti i Shtetit në faqen e internetit: www.state.gov/j/tip/.

c. Ndalimi i punës së të miturve dhe mosha e lejuar për punësim

Ligji përcakton moshën 16 vjeç si moshë minimale të lejuar për punësim dhe rregullon sasinë dhe llojin e punës që mund të kryejnë fëmijët nën moshën 18 vjeç. Fëmijët nga 16 deri në 18 vjeç mund të punojnë në disa punë të përcaktuara. Ndonëse ligji përcakton Ministrinë e Rinisë dhe Mirëqenies Sociale si përgjegjëse për zbatimin e kërkesave për moshën e lejuar për punësim nëpërmjet gjykatave, ajo nuk e zbatoi ligjin siç duhet. Inspektorët e punës hetuan sektorin formal të punës ndërsa fëmijët në pjesën më të madhe të rasteve punësohen në tregun joformal. Pjesa më e madhe e inspektimeve të punës u bë në fabrika këpucësh dhe tekstilesh dhe u gjendën disa raste fëmijësh të punësuar gjatë këtyre inspektimeve.

Në korrik agjencia qeveritare e statistikave dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës raportuan se 54.000 fëmijë ishin detyruar të punonin në sektorin familjar të punësimit të fëmijëve. Llogaritet të jenë rreth 43.000 fëmijë që punonin në ferma dhe peshkim, 4.400 në sektorin e shërbimeve dhe 2.200 në hotele dhe restorante. Afro 7 për qind e fëmijëve ishin nën moshën e lejuar për punë.

Qeveria përmirësoi bashkëpunimin mes inspektoratit të punës dhe njësive bashkiake për të drejtat e fëmijëve. U trajnuan 120 inspektorë për monitorimin e punës së të miturve dhe u krijua një strategji inspektimi për punën e të miturve për periudhën 2013-20.

Ligji dënon shfrytëzimin e fëmijëve për punë dhe shërbime të detyruara, por qeveria nuk e zbatoi si duhet ligjin. Raportet vërejtën se pjesa më e madhe e të miturve të punësuar punonin si shitës në dyqane, lypës, fermerë, barinj, shpërndarës droge, larës automjetesh, punonjës në fabrika tekstile, minatorë ose lustraxhinj. Disa prej fëmijëve që lypnin në rrugë ishin brezi i dytë ose i tretë lypësish. Kërkimet tregojnë se lypja fillon që në moshën katër ose pesë vjeç. Ndërsa kodi penal ndalon shfrytëzimin e fëmijëve për lypje, policia në përgjithësi nuk ka zbatoi ligjin. Qeveria nuk ka siguruar burime për rehabilitimin e fëmijëve që lypnin dhe jetonin në rrugë.

Shikoni gjithashtu *Të dhënat mbi Format më të Këqija të Punës së të Miturve* nga Departamenti i Punës në faqen e internetit:www.dol.gov/ilab/programs/ocft/tda.htm.

d. Kushtet e pranueshme të punës

Paga minimale kombëtare ishte 22.000 lekë (211 dollarë) në muaj. Sipas agjencisë qeveritare të statistikave paga mesatare për punonjësit e qeverisë në çerekun e dytë të vitit ishte 51.700 lekë (496 dollarë) në muaj. Në mënyrë krahasuese, pragu i varfërisë në rang kombëtar në vitin 2012 ishte 6.472 lekë (62 dollarë) në muaj. Agjencia e statistikave raportoi se pagat mesatare mujore në sektorin publik në fund të çerekut të dytë të vitit ishin rritur me 5,9 për qind nga e njëjta periudhë në vitin 2012. Kodi i punës kërkon pagesë të njëjtë për punë të barabartë.

Ministria e Rinisë dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për zbatimin e pagës minimale. Ndërsa ligji përcakton javën e punës me 40 orë, janë marrëveshjet individuale apo kolektive ato që në të vërtetë caktojnë javën e punës. Ligji përcakton pushime të paguara vjetore por vetëm

punonjësit në tregun formal të punës patën të drejta të garantuara për pushime të paguara. Shumë punonjës kanë punuar gjashtë ditë në javë. Ligji kërkon pagesën e punës jashtë orarit ose në ditët e pushimeve por punëdhënësit nuk i kanë marrë parasysh gjithmonë këto dispozita. Ligji kufizon numrin maksimal të orëve të punës në javë deri në 50 dhe parashikon pagesë shpërblyese për punën jashtë orarit. Qeveria nuk pati standarde për një numër minimal orësh pushimi në javë dhe rrallë zbatoi ligjet që kishin të bënin me orët maksimale të punës, kufirin për orë pune jashtë orarit, apo pagesën ekstra për punën jashtë orarit. Këto ligje shpesh nuk funksiononin për punonjësit në sektorin joformal si punonjësit në shtëpi dhe punonjësit migrantë.

Ministria e Rinisë dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për zbatimin e standardeve dhe rregullave të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Mungonte tërësisht zbatimi. Kushtet në vendin e punës shpesh ishin shumë të këqija dhe në disa raste të rrezikshme. Ndëshkimet shpesh nuk kanë frenuar shkeljet sepse agjencitë e zbatimit të ligjit nuk kishin mjetet për të zbatuar mbledhjen e gjobave dhe si rrjedhojë rrallë ngritën bërë akuza për kundravajtje. Nuk pati programe qeveritare për sigurimin e mbrojtjes sociale për punonjësit në ekonominë joformale.

Pati shkelje të shpeshta të standardeve të sigurisë profesionale dhe pagave, më shpesh në industritë tekstile dhe ato të këpucëve, ndërtim, si edhe në miniera.